

## **EMA vlerëson të dhënat për dozën përforcuese (booster) të vaksinës COVID-19 Comirnaty tek adoleshentët**

Lajme 08/02/2022

Agjencia Europiane e Barnave (EMA) ka filluar vlerësimin e një aplikacioni për përdorimin e një doze përforcuese të Comirnaty (vaksina BioNTech/Pfizer) tek adoleshentët e moshës 12 deri në 15 vjeç. Një aplikim për adoleshentët e moshës 16 deri në 17 vjeç është gjithashtu në vazhdim.

Doza përforcuese u jepet personave të vaksinuar (d.m.th. njerëzve që kanë përfunduar vaksinimin e tyre parësor) për të rivendosur mbrojtjen pasi të jetë dobësuar. Një dozë përforcuese e Comirnaty mund të jepet aktualisht tek individët 18 vjeç e lart.

Komiteti i barnave për përdorim human i EMA (CHMP) do të kryejë një vlerësim të përshpejtuar të të dhënave të paraqitura nga kompania që tregton Comirnaty, duke përfshirë rezultatet nga të dhënat e praktikës e përgjithshme (ang. real world data) nga Izraeli. EMA do të komunikojë rezultatin e vlerësimit në kohën e duhur.

Këshillat se si duhet të bëhen vaksinimet mbeten prerogativ i grupeve kombëtare këshilluese teknike të imunizimit që drejtojnë fushatat e vaksinimit në çdo Shtet Anëtar të UE-së. Organet kombëtare të shëndetit publik mund të nxjerrin rekomandime zyrtare për përdorimin e dozave përforcuese dhe për kërkesat përkatëse të certifikimit të udhëtimit, duke marrë parasysh të dhënat e reja të efektivitetit dhe të dhënat e kufizuara të sigurisë.

Comirnaty është një vaksinë për parandalimin e COVID-19. Ai përmban një molekulë të quajtur ARN mesenxher (ARNm) me udhëzime për prodhimin e një proteine, të njohur si proteina gjembore (proteina spike), e pranishme natyrshëm në SARS-CoV-2, virusi që shkakton COVID-19. Vaksina funksionon duke përgatitur trupin për t'u mbrojtur kundër SARS-CoV-2.

Më shumë informatat mund të gjenden në vegzën:

<https://www.ema.europa.eu/en/news/ema-evaluating-data-booster-dose-covid-19-vaccine-comirnaty-adolescents>